



REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA GLOGOC GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranuar		12/08/	2020
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
08	0306/1-	30898	

KOMUNA GLOGOC

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Duke u bazuar në Ligjin Nr.03/L-230 për Vlerësimin Strategjik Mjedisor, Neni 9, paragrafët 1, 2, 3, nënparagrafët 3.1, 3.2, 3.3, Komuna e Glogocit organizon:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor (VSM) për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit 2020-2028

Ftohen të gjithë të interesuarit që të marrin pjesë në debatin publik që do të mbahet në Glogoc, me datën 24.08.2020 në ora 11:00, në sallën e Kuvendit Komunal.

Komuna e Glogocit, ka përfunduar Raportin për Vlerësimin Strategjik Mjedisor për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit 2020-2028. Kontributi i të gjithë të interesuarve, duke përfshirë shoqërinë civile, profesionistët dhe ekspertët e fushave relevante është i rëndësishëm dhe i nevojshëm për përfundimin e procedurave për aprovimin e raportit të VSM-së për Hartën Zonale të Komunës së Glogocit. Prandaj, duke pasur parasysh ndjeshmërinë dhe ndikimin që mund të ketë ky dokument, inkurajohen të gjithë të interesuarit të marrin pjesë në debat, dhe të kontribuojmë në ngritjen e kualitetit dhe masave për mbrojtjen e mjedisit.

Raportin e VSM-së mund ta gjeni dhe ta shkarkoni edhe nga ueb faqja e Komunës së Glogocit (<https://kk.rks-gov.net/glogoc/>), ndërsa komentet e juaja mund ti dërgoni në email adresën komuna.drenas@rks-gov.net.

Mbajtja e këtij takimi do të bëhet konform masave mbrojtëse të parapara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike.

Glogoc, 10.08.2020



Drejtor i DPUMM
Flutura Avdiu